



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 12, datë 18.10.2023

Për

“Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “NJË NDRYSHIM TË VKM NR. 750, DATË 1.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
Z. Armer	Juka	Anëtar
Z. Bleron	Dokle	Anëtar
Z. Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 18.10.2023, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.2.2017, me propozim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “NJË NDRYSHIM TË VKM NR. 750, DATË 1.12.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023.***

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3, e nenit 114 dhe nenit 115, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr.46/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”;

3. Pika 1, e nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 34/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar;
5. VKM nr.750, datë 01.12.2022, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2023”;
6. VKM nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”;
7. VKM- së nr. 326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”;
8. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16 datë 16.06.2023, “Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023” (projektvendimi);
2. Relacioni mbi projektvendimin (**Relacioni**);

V Ë R E N :

1. Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 117, të ligjit nr. 9918/2008, paraqitet për miratim pranë këshillit drejtues të AKEP, projektvendimi për “Propozimin Ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë për “Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022, për miratimin e buxhetit për AKEP për vitin 2023”, ndërkohë që më poshtë listohen aktet ligjore dhe nënligjore, hyrja në fuqi e të cilave reflekton ndryshime me efekt ndjeshëm rritës të zërit të shpenzimeve për pagat e punonjësve të AKEP.
2. Ligji nr. 34/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, përmban përcaktimin me efekt rritës të masës së pagës mujore të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe me të njëjtin efekt të anëtarëve të Këshillit Drejtues të institucionit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*, përcakton strukturën e re të pagave, nivelet dhe shtesa të tjera mbi pagë, ndër të tjera edhe për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, duke përfutur rritje page, konkretisht, 68 nëpunës civil dhe 4 funksionarë të kabinetit të Kryetarit të AKEP.
4. VKM nr. 326, datë 31.5.2023 *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, ndërkohë që AKEP ka në strukturën organizative 8 punonjës mbështetës, të cilët përfutjnë rritje page nga ndryshimet e mësipërme.
5. Gjithashtu, të dy vendimet e lartpërmendur të Këshillit të Ministrave, parashikojnë shtesa page për vjetërsi në punë, apo për vështirësi në vendin e punës. Në këtë kontekst Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar kreu llogaritjet në listëpagesat e muajit qershor dhe rishikoi listëpagesat e muajit prill dhe maj, si dhe kreu deklaratimet përkatëse në sistemin e tatimeve për ndryshimet e pagave.
6. Vlera e rritjes së fondit të pagave llogaritet të jetë në vlerën prej 14,830,373 lekë fond page, si dhe Zëri shpenzime për sigurinë shoqërore dhe shëndetësore në vlerën e 2,411,758 lekë. Në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të lartpërmendura, AKEP e konsideron determinante rishikimin e strukturës së fondit të shpenzimeve për vitin 2023, konkretisht, duke alokuar kursimet nga:
 - a. *procesi i prokurimeve në zërin e shpenzimeve për investime në vlerën e 2,240,000 lekë;*
 - b. *zëri i shpenzimeve për shërbime në vlerën e 15,002,131 lekë, e cila rrjedh nga kursimet nga prokurimet e zërave të shërbimeve, kryesisht të platformave teknologjike;*
 - c. *zbritja e kontributit për vitin 2023 në organizata ndërkombëtare, si BEREC, ku, nga kontributi i derdhur në vitet e mëparshme janë akumuluar një tepriçë, kështu që për vitin 2023 nuk kemi pagesë;*
 - d. *si dhe kursimet nga zërat e shpenzimeve të tjera.*
7. Kjo, rrjedhimisht sjell domosdoshmërinë e hartimit dhe përcjelljes së këtij akti pranë Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim ushtrimin e kompetencave kushtetuese sa i përket ndryshimit të Strukturës së Fondit të Shpenzimeve Administrative të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, miratuar me VKM nr. 750, datë 1.12.2022, *“Miratimin e Buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2023”*.
8. Rishpërndarja e fondit të shpenzimeve, sikurse parashtrohet në Lidhjen 1, reflekton mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara, sipas burimeve ligjore të financimit për AKEP, të parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore e më konkretisht, nenin 119, të ligjit nr. 9918/2008, dhe nenin 27, të ligjit nr. 46/2015, që realizohet nëpërmjet zërit të pagesave për AKEP të miratuara për vitin 2023.
9. Të ardhurat e parashikuara sipas burimeve të financimit, janë llogaritur në të njëjtin nivel me atë të fondit të shpenzimeve administrative në total, në përputhje me statusin ligjor të AKEP si person juridik, publik, jo buxhetor dhe i pavarur, i krijuar me ligj të veçantë.

10. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin e Këshillit Drejtues për “Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023”, jep sqarime të hollësishme ligjore dhe financiare mbi të gjithë zërat e fondit të shpenzimeve të parashikuara dhe projektbuxhetin e vitit 2023.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen projektaktin “Propozimin tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për “Një ndryshim të VKM nr. 750, datë 1.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2023”, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore të listuara në pikën “Baza Ligjore”, përshirë dhe dispozitat përkatëse rregullatore të Rregullores së Brendshme të AKEP;

V E N D O S:

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve administrative të parashikuara, në shumën 381,500,000 lekë (treqind e tetëdhjetë e një milion e pesëqind mijë) lekë, të ndarë sipas zërave që paraqiten në Lidhjen 1, bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Fondi i shpenzimeve administrative të rishikuar për vitin 2023, sipas pikës 1 dhe lidhjes 1 shoqëruese të vendimit, t’i dërgohen Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim propozimin pranë Këshillit të Ministrave me qëllim ndryshimin e VKM nr. 750, datë 1.12.2022, “Miratimin e buxhetit për AKEP, për vitin 2023”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e procedurave deri në miratimin e fondit të shpenzimeve administrative për vitin 2023 të AKEP.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Armer Juka	Bleron Dokle